



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 239

Tiranë – E hënë, 8 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 29.12.2017	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2018..... 13257
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 29.12.2017	Për emërimin në detyrë të disa anëtarëve të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile..... 13527
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 29.12.2017	Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ndërmarrjes së Ujësjetës-Kanalizimeve, Korçë, si Agjenci e Zbatimit të Projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Kanalizimet e ujërave të zeza Korçë, III”..... 13258
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 29.12.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i pikës së kalimit kufitar të përbashkët Morinë - Vermicë, Kukës”.... 13259
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 29.12.2017	Për kompensimin e familjeve të fshatrave Zall-Mëner dhe Bulqesh, komuna Zall-Bastar, që preken nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës”..... 13260
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 29.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 1069, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për tjetërsimin e pronësisë shtetërore “truall”, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)””..... 13262

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 29.12.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 383, datë 19.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar.....	13262
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e institucioneve të autorizuar për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar.....	13263
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 117, datë 17.2.2011; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 42, datë 24.4.2015, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara”.....	13264
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 29.12.2017	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 20.4.2017, për çështjen “Ana Veizi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 16191/13).....	13269
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e mjediseve të ndërtesës “godina e inovacionit” në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)”.....	13269
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Korro.....	13271

**VENDIM****Nr. 794, datë 29.12.2017****PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË, JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, dhe të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe në vijim të pikave 2, 3 dhe 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht për vitin 2018, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2018, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 15 (pesëmbëdhjetë).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, janë:

a) të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013.

b) të zotërojnë një diplomë të nivelit “master shkencor” ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomë, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

c) të kenë, të paktën, 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme, në:

- institucione të administratës publike;
- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 vite që janë krijuar.

Përjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;
- pedagogë në institucione të arsimit të lartë;
- avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar, brenda ose jashtë vendit,
- duhet të kenë, të paktën, 5 vite përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 795, datë 29.12.2017****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DISA ANËTARËVE TË BORDIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin në detyrë të disa anëtarëve të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues të institucioneve të administratës publike qendrore, si më poshtë vijon:

- Znj. Majlinda Dhuka;
- Z. Endri Fuga;



- Znj. Gelardina Prodanj;
- Z. Oltjon Muzaka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 800, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE
PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE, KORÇË, SI AGJENCI
E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN, PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT
“KANALIZIMET E UJËRAVE TË ZEZA
KORÇË, III”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Ndërmarrjes së Ujësjetellës-Kanalizimeve, Korçë, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Kanalizimet e ujërave të zeza Korçë, III”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KfW Bankengruppe, Postfach
111141, 60046 Frankfurt am Main

Fusha e biznesit
KfW Entwicklungsbank

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Ministër Arben Ahmetaj
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
nr. 1
Tiranë, Shqipëri

Jan Kleinheisterkamp
Ref. jonë: Khtk/Tch
Tel.: +49 86 7431-2594
Faks: +49 86 7431-2547
Jan.kleinheisterkamp@kfw.de

Në vëmendje të:
KfW- Zyra Tiranë
Z. Bledar Dollaku,
Koordinator i projektit
Tiranë, Shqipëri

Datë 10.11.2016

LEa/4 - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Përdorimi i fondeve të mbetura të projektit “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë III” (BMZ-ID 2003 66 609) për shlyerje huash

I nderuar ministër Ahmetaj,

Projekti “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë III” ka përfunduar në vitin 2012. Projekti është financuar nga një grant nga BMZ-ja, në shumën 5 milionë euro, nga të cilat 168,028.17 euro nuk janë përdorur dhe janë fonde të mbetura. Marrëveshja përkatëse e financimit dhe e projektit është nënshkruar më 3 maj 2005.

Është e qartë tashmë që për fazën tjetër “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë IV” nuk janë të nevojshme fonde shtesë. Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, ka mundësinë për të përdorur fondet e mbetura për shlyerjen e një huaje të KfW-së, mundësisht në të njëjtin sektor.

Ju lutem, na informoni nëse do të zgjidhni përdorimin e fondeve të mbetura për shlyerjen e një huaje të KfW-së, duke nënshkruar më poshtë.

Me respekt,

Dr. Kirk Mildner **Jan Kleinheisterkamp**
Përgjegjës sektori Menaxher i projektit

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, 30.12.2016

Nënshkrimi: _____

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë:

Emri: Arben Ahmetaj

Pozicioni: Ministër i Financave

**VENDIM****Nr. 801, datë 29.12.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I PIKËS SË KALIMIT
KUFITAR TË PËRBASHKËT
MORINË – VËRMICË, KUKËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i pikës së kalimit kufitar të përbashkët Morinë – Vërmicë, Kukës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 41 976 (dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) m², me vlerë shpronësimi 20 724 (njëzet mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë;

b) tokë “arë”, me sipërfaqe 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) m², me vlerë shpronësimi 21 252 (njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit, prej 41 976 (dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e

gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si subjekt kërkuar i këtij shpronësimi.

5. Pronarët e pasurive, që shpronësohen sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONARËVE PRIVATË QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË PIKËS
SË KALIMIT TË PËRBASHKËT MORINË – VËRMICË, BASHKIA KUKËS

Fshati	Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale, lekë	Lloji i vërtetimit
M o r i n ë	1	Rive Iljaz Duraku	2724	91/16	Arë	157	132	20,724	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	2	Rive Iljaz Duraku	2724	83/17	Arë	161	132	21,252	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		SHUMA				318	132	41,976	

VENDIM

Nr. 803, datë 29.12.2017

**PËR KOMPENSIMIN E FAMILJEVE TË
FSHATRAVE ZALL-MËNER DHE BULÇESH,
KOMUNA ZALL-BASTAR, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I UJËMBLEDHËSIT
TË BOVILLËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e 80 familjeve të fshatrave Zall-Mëner dhe Bulçesh, komuna Zall-Bastar, të cilat preken nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës, sipas parashikimeve të vendimit nr. 317, datë 19.6.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të fshatrave Zall-Mëner, Bulçesh dhe Brurëz”, të ndryshuar.

2. Familjet të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 400 (katërqind) m² për frymë, me vlerë të përgjithshme 82 611 200 (tetëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 82 611 200 (tetëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, miratuar në buxhetin e vitit 2017.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 3, të kryejë likuidimet, në bazë të pikës 2, të këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E EMËRORE E KRYEFAMILJARËVE TË FSHATIT BULÇESH

Nr.	Pronari		Nr. i frymëve	Sipërfaqja që shpronësohet (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera totale (lekë)
	Emri	Mbiemri				
1	Ali	Sala	4	400	448	716800
2	Ibrahim	Sala	5	400	448	896000
3	Fadil	Sala	4	400	448	716800
4	Islam	Sala	4	400	448	716800
5	Halil	Aruci	4	400	448	716800
6	Hajrie	Aruci	3	400	448	537600
7	Xhemal	Aruci	3	400	448	537600
8	Hajdar	Aruci	3	400	448	537600
9	Ahmet	Aruci	6	400	448	1075200
10	Osman	Basha	11	400	448	1971200
11	Xhemal	Tafa	7	400	448	1254400
12	Selman	Tafa	8	400	448	1433600
13	Ismail	Tafa	6	400	448	1075200
14	Bajram	Tafa	6	400	448	1075200
15	Hanke	Ahmeti	5	400	448	896000
16	Sulejman	Sala	7	400	448	1254400
17	Sabri	Sala	7	400	448	1254400
18	Nezir	Sala	7	400	448	1254400
19	Beqir	Sala	10	400	448	1792000
20	Sulejman	Hoxha	8	400	448	1433600
21	Ahmet	Luca	8	400	448	1433600
22	Kadri	Luca	6	400	448	1075200
23	Myslym	Luca	4	400	448	716800
24	Skender	Mucalla	4	400	448	716800
25	Haxhi	Hoxha	12	400	448	2150400
26	Mexhit	Hoxha	4	400	448	716800
27	Shefqet	Hoxha	4	400	448	716800
28	Nazmi	Hoxha	1	400	448	179200
29	Hasan	Hoxha	7	400	448	1254400
30	Bajram	Hoxha	4	400	448	716800
31	Beqir	Hajdini	9	400	448	1612800
32	Rexhep	Hajdini	14	400	448	2508800
33	Aishe	Hajdini	4	400	448	716800
34	Mehmet	Hajdini	5	400	448	896000
35	Adem	Hajdini	5	400	448	896000
36	Fatmir	Hajdini	3	400	448	537600
37	Halil	Paja	4	400	448	716800
38	Nuri	Paja	7	400	448	1254400
39	Rustem	Mansi	5	400	448	896000
40	Selim	Mansi	4	400	448	716800
41	Sajrie	Mansi	4	400	448	716800
42	Riza	Dishmeta	7	400	448	1254400
43	Ahmet	Dishmeta	3	400	448	537600
44	Ali	Dishmeta	9	400	448	1612800
45	Liman	Dishmeta	7	400	448	1254400
46	Haxhi	Dishmeta	3	400	448	537600
47	Agim	Basha	12	400	448	2150400
48	Sali	Basha	7	400	448	1254400
49	Skender	Basha	7	400	448	1254400
50	Ismail	Basha	6	400	448	1075200
51	Mereme	Basha	7	400	448	1254400
52	Qamil	Basha	5	400	448	896000
53	Mustafa	Basha	7	400	448	1254400
54	Vesel	Basha	8	400	448	1433600
55	Avdi	Basha	7	400	448	1254400
56	Fadil	Dervishi	6	400	448	1075200
57	Haki	Dervishi	5	400	448	896000
58	Qerim	Dervishi	6	400	448	1075200
59	Beqir	Basha	6	400	448	1075200
60	Mejte	Basha	1	400	448	179200
61	Haxhi	Basha	7	400	448	1254400



62	Xhemal	Basha	2	400	448	358400
63	Xhumaje	Basha	7	400	448	1254400
64	Ngushelim	Luca	4	400	448	716800
65	Bujar	Luca	2	400	448	358400
66	Shyqyri	Luca	3	400	448	537600
67	Halil	Cali	9	400	448	1612800
68	Riza	Cali	2	400	448	358400
69	Ramazan	Cali	6	400	448	1075200
70	Like	Cali	7	400	448	1254400
71	Hasan	Cali	6	400	448	1075200
72	Bajram	Cali	9	400	448	1612800
73	Ismail	Cali	5	400	448	896000
74	Beqir	Cali	6	400	448	1075200
75	Ahmet	Cali	8	400	448	1433600
76	Hamide	Cali	1	400	448	179200
77	Hysen	Cali	4	400	448	716800
78	Sali	Dishmeta	8	400	448	1433600
79	Abaz	Dishmeta	2	400	448	358400
80	Nezir	Basha	8	400	448	1433600
SHUMA TOTALE						82611200

VENDIM**Nr. 804, datë 29.12.2017**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1069, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE “TRUALL”, NGA PRONË SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, PËR SHOQËRINË “BLOJA” SHPK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS (KOMUNA E PARISIT – RRUGA E KAVAJËS)””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, dhe 8, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr. 1069, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

Faqe | 13262

“1. Tjetërsimin e pasurisë shtet, me sipërfaqe 703 (shtatëqind e tre) m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 3866, me numër pasurie 521/1, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 805, datë 29.12.2017**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 383, DATË 19.5.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 7, të vendimit nr. 383, datë 19.5.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rast se në listat e përfituesve, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, konstatohen



gjenealitete të ndryshme të subjekteve nga ato faktike të tyre, atëherë ATP-ja ka të drejtë të verifikojë dhe të provojë, bazuar në të dhënat e përgjithshme të pasurisë dhe të trashëgimisë të marra në institucionet e treta, se gjenealitetet e subjekteve përfituese janë të njëjta me ato të subjekteve të publikuara në listat e vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 806, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 824, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, e 11, pika 1, të ligjit nr. 9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika I ndryshohet si më poshtë vijon:

“I. Institucionet, që autorizohen për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, janë:

1. Zyra e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
3. Kryeministria;
4. Gjykata Kushtetuese;
5. Prokuroria e Përgjithshme;
6. Prokuroria e Posaçme;
7. Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;

8. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm;

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor;

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

11. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

12. Kontrolli i Lartë i Shtetit;

13. Banka e Shqipërisë;

14. Të gjitha ministratë e linjës;

15. Të gjitha institucionet në varësi të Kryeministrit apo të ministrave të linjës;

16. Degët territoriale të ministrave ose institucioneve të varësisë;

17. Njësitë e vetëqeverisjes vendore;

18. Interpoli;

19. Misionet diplomatike, me autorizim të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

20. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, për shërbimet konsullore që ofrohen për shtetasit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë;

21. Misioni diplomatik i Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë;

22. Zyra e Këshillit të Evropës në Republikën e Shqipërisë;

23. Enti Rregullator i Energjisë;

24. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

25. Autoriteti i Aviacionit Civil;

26. Autoriteti Portual;

27. Shkolla e Magistraturës;

28. Çdo institucion tjetër shtetëror, që paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe pajiset prej saj me kodet hyrëse (*user name* dhe *password*) të regjistrat elektronik të gjendjes gjyqësore.”.

b) Në pikën I/1, fjalët “... legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale ...” zëvendësohen me “... sigurisë së sistemit të të dhënave dhe të fshehtësisë të të dhënave personale të shtetasve ...”.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 807, datë 29.12.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 611,
DATË 11.6.2009; NR. 677, DATË 18.6.2009;
NR. 706, DATË 23.6.2009; NR. 805, DATË
22.7.2009; NR. 1283, DATË 23.12.2009; NR.
125, DATË 17.2.2010; NR. 247, DATË
13.4.2010; NR. 404, DATË 26.5.2010; NR. 549,
DATË 7.7.2010; NR. 646, DATË 28.7.2010;
NR. 513, DATË 1.8.2012; NR. 117, DATË
17.2.2011; NR. 345, DATË 24.4.2013; NR. 42,
DATË 24.4.2015, PËR MIRATIMIN E
KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA
PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR
TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE
INFORMALE, TË NDRYSHUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshimet, si më poshtë vijnë:

a) Në vendimin nr. 611, datë 11.6.2009, ndryshohen gjenealitetet e poseduesit për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 13/118, sipas lidhjes G që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në vendimin nr. 677, datë 18.6.2009, ndryshohen gjenealitetet e poseduesve për dy parcela ndërtimore me nr. pasurie 6/680 dhe 4/299, sipas lidhjes H që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Në vendimin nr. 706, datë 23.6.2009, ndryshohen gjenealitetet e poseduesve për dy parcela ndërtimore me nr. pasurie 10/448 e 10/439, sipas lidhjes I që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ç) Në vendimin nr. 805, datë 22.7.2009, ndryshohet sipërfaqja për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 3/600, sipas lidhjes J që i bashkëlidhet këtij vendimi.

d) Në vendimin nr. 1283, datë 23.12.2009, shfuqizohet kalimi i pronësisë për katër parcela ndërtimore me nr. pasurie 9/536, 9/542, 9/535 e 9/534, sipas lidhjes M që i bashkëlidhet këtij vendimi.

dh) Në vendimin nr. 125, datë 17.2.2010, shfuqizohet kalimi i pronësisë për shtatëmbëdhjetë parcela ndërtimore me nr. pasurie 652/6, 652/3, 7/403, 7/407, 7/482, 7/404, 7/427, 7/485, 7/422, 7/421, 7/438, 7/423, 7/496, 7/408, 7/418, 7/414 e 7/417, sipas lidhjes N që i bashkëlidhet këtij vendimi.

e) Në vendimin nr. 247, datë 13.4.2010, ndryshohet sipërfaqja për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 4/604 dhe shfuqizohet kalimi i pronësisë për dy parcela ndërtimore me nr. pasurie 9/501 dhe 9/539, sipas lidhjes O që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ë) Në vendimin nr. 404, datë 26.5.2010, shfuqizohet kalimi i pronësisë për dy parcela ndërtimore me nr. pasurie 315/474/1 e 258/99, sipas lidhjes P që i bashkëlidhet këtij vendimi.

f) Në vendimin nr. 549, datë 7.7.2010, shfuqizohet kalimi i pronësisë për tetë parcela ndërtimore me nr. pasurie 7/639, 9/653, 7/661, 10/331, 7/677, 7/686, 7/641 e 7/681 dhe ndryshohet sipërfaqja për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/636, sipas lidhjes Q që i bashkëlidhet këtij vendimi.

g) Në vendimin nr. 646, datë 28.7.2010, shfuqizohet kalimi i pronësisë për pesë parcela ndërtimore me nr. pasurie 7/419, 7/695, 7/420, 7/678 e 7/713 dhe ndryshohen gjenealitetet e poseduesit për dy parcela ndërtimore me nr. pasurie 5/852 dhe 7/407/2, sipas lidhjes R që i bashkëlidhet këtij vendimi.

gj) Në vendimin nr. 513, datë 1.8.2012, ndryshohen gjenealitetet e poseduesit për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 23/197, sipas lidhjes V që i bashkëlidhet këtij vendimi.

h) Në vendimin nr. 117, datë 17.2.2011, ndryshohen gjenealitetet e poseduesit për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 10/370, sipas lidhjes ZH që i bashkëlidhet këtij vendimi.

i) Në vendimin nr. 345, datë 24.4.2013, ndryshohet sipërfaqja për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 9/260 dhe shfuqizohet kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 129/15, sipas lidhjes AA që i bashkëlidhet këtij vendimi.



j) Në vendimin nr. 42, datë 24.4.2015, ndryshohet numri i pasurisë për parcelën ndërtimore, nga 1065 në 834/10, sipas lidhjes AH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT
TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE
LISTA EMËRORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PËR KORRIGJIM

LIDHJA G										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
1	TIRANA VERI	ISHTE	HAKHI	HYSEN	SULAJ	2890	8320	13/118	500.4	
		BEHET	ARBEN ARDIAN	HAKHI HAKHI	SULAJ SULAJ	2890, 2896	8320	13/110	500.4	
LIDHJA H										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
2	TIRANA VERI	ISHTE	PREL	DEDE	ZYLA	3647, 857	8310	6/680	328	
		BEHET	PRELE NDREKE	DEDE DEDE	ZYLE ZYLE	3647	8310	6/680	326	
3	TIRANA VERI	ISHTE	ALI	NEBI	XHAKOLLARI	3706	8310	4/299	357	
		BEHET	ALI ZYBAKO	NEBI MYRTEZA	XHAKOLLARI XHAKOLLARI	3706, 934	8310	4/299	355.6	
LIDHJA I										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
4	TIRANA VERI	ISHTE	XHAFERR	AHMET	MULGECI	1309	8310	10/440	447	
		BEHET	XHAFER	AHMET	MULGECI	1252	8310	10/440	447	
			CAN	AHMET	MULGECI					
5	TIRANA VERI	ISHTE	NDUE	ZEF	BARDHI	1090, 3995	8310	10/439	500	
			NDREC	NDUE	BARDHI					
		BEHET	MARTIN NDREC FRROK	ZEF NDUE NDUE	BARDHI BARDHI BARDHI	1090, 3995, 2063	8310	10/439	500	
LIDHJA J										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
6	KORÇE	ishite	Myftinia Korçe Xhamia Maliq			182	2575	3/606	210.6	
		behate	Myftinia Korçe Xhamia Maliq			182	8563	3/606	330.3	
LIDHJA K										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
7	TIRANA JUG	ISHTE	HAVA	AHMET	MURATI	2133	6170	9/536	245.6	
		BEHET	ANULLOHET							
8	TIRANA JUG	ISHTE	LUAN	ZENEL	BALLIU	387	6170	9/542	202.1	
		BEHET	ANULLOHET							
9	TIRANA JUG	ISHTE	SHEQERE	ISUF	MURATI	2134	6170	9/535	210.9	
		BEHET	ANULLOHET							
10	TIRANA JUG	ISHTE	BEGIR	AHMET	MURATI	2168	6170	9/534	167	
		BEHET	ANULLOHET							
LIDHJA N										
NR REKOR	QELQJA	KATEGORI	EMRI	ATRI	NUMERI	NR PROTOULLI VETESLAMPFIER LIGJIT	ZONA KATEGORIALE	NUMRI PASURIE	SHIFRA E FAKETES KORRIGJIMIT (NUMERI I PASURISË)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	
11	TIRANA RURALE	ISHTE	REFIK	RASIM	HASIMUCA	2632	2529	652/8	426.6	
		BEHET	anullohet							



12	TIRANA RURALE	ISHTE	MALIQ,REFIK	RASIM	HASMUCA	2633	2529	652/3	426.7
		BEHET	anullohet						
13	TIRANA JUG	ISHTE	SHEQERE	SERJAN	BALLI	137	8170	7/403	217
		BEHET	anullohet						
14	TIRANA JUG	ISHTE	BEDRI	MERSIN	KOCI	2227	8180	7/407	413
		BEHET	anullohet						
15	TIRANA JUG	ISHTE	BASHKIM	YMER	DUKA	493	8180	7/482	355
		BEHET	anullohet						
16	TIRANA JUG	ISHTE	NAIME	QAMIL	RRAFMANI	902	8180	7/404	237
		BEHET	anullohet						
17	TIRANA JUG	ISHTE	SHEFQET	RESHIT	BALLA	197	3976	7/427	421
		BEHET	anullohet						
18	TIRANA JUG	ISHTE	TAULANT	RIZA	RRAFMANI	919	8180	7/485	202
		BEHET	anullohet						
19	TIRANA JUG	ISHTE	SHPETIM	ABDULLA	COKU	197	3976	7/422	333
		BEHET	anullohet						
20	TIRANA JUG	ISHTE	VLADIMIR	KUJTIM	BALLA	2118	8170	7/421	329
		BEHET	anullohet						
21	TIRANA JUG	ISHTE	OEMAL	DEMIR	KROQI	541	3976	7/438	336
		BEHET	anullohet						
22	TIRANA JUG	ISHTE	FETI	ABDULLA	COKU	196	3976	7/423	211
		BEHET	anullohet						
23	TIRANA JUG	ISHTE	EDMOND	ABDULLA	COKU	196	3976	7/496	490
		BEHET	anullohet						
24	TIRANA JUG	ISHTE	XHEVAHIR	JAKUP	KAMBERI	1650	8180	7/408	198
		BEHET	anullohet						
25	TIRANA JUG	ISHTE	ISLAM	YMER	KARAJ	573	3976	7/418	316
		BEHET	anullohet						
26	TIRANA JUG	ISHTE	NEVREZ	MELEQ	SHALCANI	521	3976	7/414	241
		BEHET	anullohet						
27	TIRANA JUG	ISHTE	DERVISH	SELIM	AHMETAJ	1690	3976	7/417	165
		BEHET	anullohet						
LIDHJA O									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORÇUNI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLL I VETEDKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURJES	SIPERFQAJA E PARCELES NDRITIMORE PER KALIM (PUSHE) (P ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
28	KORÇE	Ishte	DHIMITRI	LIGOR	VANKO	A-218	8563	4/604	44.8
		Behet	DHIMITRI	LIGOR	VANKO	A-218	8563	4/661	73.1
29	TIRANA JUG	ISHTE	HAMIT	MEHMET	MYFTARI	1427	8170	9/501	300
		BEHET	ANULLOHET						
30	TIRANA JUG	ISHTE	ABAZ	REXHEP	HASANAJ	1783	8170	9/539	280
		BEHET	ANULLOHET						
LIDHJA P									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORÇUNI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLL I VETEDKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURJES	SIPERFQAJA E PARCELES NDRITIMORE PER KALIM (PUSHE) (P ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
31	TIRANA JUG	Ishte	ERMIRA	AVDI	IMERAJ	3283	3866	315/474/1	298
		Behet	ANULLOHET						
32	TIRANA JUG	ISHTE	OSMAN	MEHEMET	HYSA	818	8180	258/99	375
		BEHET	ANULLOHET						



LIDHJA Q									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORÇUMI	EMER	ATEI	MËSHER	NR PROTOKOLLIT VETËDËSHËR PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIS	SIPERFALIA E PARCELES KONTINGJENT PËR KLASIFIKIMIN (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
33	TIRANA JUG	ISHTE	REFAT	ELMAZ	KARAJ	2384	3976	7/639	227
		BEHET	ANULLOHET						
34	TIRANA JUG	ISHTE	BERAM	HAXHI	DUKA	2575	8170	9/653	254
		Behet	ANULLOHET						
35	TIRANA JUG	ISHTE	HALIT	JAKUP	KAMBERI	2113	8180	7/661	370
		BEHET	ANULLOHET						
36	TIRANA JUG	ISHTE	ASTRIT	MURAT	XHABEJA	1091	3976	10/331	253
		BEHET	ANULLOHET						
37	TIRANA JUG	ISHTE	GANI	ZEQIR	HIDRI	419	3976	7/677	413
		BEHET	ANULLOHET						
38	TIRANA JUG	ISHTE	SHEFOET	IBRAHIM	MASHA	795	3976	7/686	282
		BEHET	ANULLOHET						
39	TIRANA JUG	ISHTE	KRESHNIK	SELIM	AHMETI	1688	3976	7/641	180
		BEHET	ANULLOHET						
40	TIRANA JUG	ISHTE	SHYQYRI	XHEMAL	VELI	1065	3976	7/681	500
		BEHET	ANULLOHET						
41	FIER	ISHTE	Maksim	Pilo	Goga	5	8532	5/636	66
			Saba	Feti	Bushi				
			Timo	Tonci	Gogu				
			Qemil	Mustaf	Bregu				
			Ligor	Andon	Dhima				
		BEHET	Maksim	Pilo	Goga	5	8532	5/636	54.5
			Timo	Tonci	Gogu				
			Saba	Feti	Bushi				
			Qemil	Mustaf	Bregu				
			Ligor	Andon	Dhima				
LIDHJA R									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORÇUMI	EMER	ATEI	MËSHER	NR PROTOKOLLIT VETËDËSHËR PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIS	SIPERFALIA E PARCELES KONTINGJENT PËR KLASIFIKIMIN (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
42	TIRANA JUG	ISHTE	ISUF	HETHEM	GUCAJ	1881/1	8180	5/852	500
		BEHET	MARGARITA	SELMAN	GUCAJ	188/1	8180	5/852	500
			ISUF	HETEM					
			VJOLLCA	HETEM	BAZAITI				
43	TIRANA JUG	ISHTE	HALIT	IMER	KARAJ	572	3976	7/419	351
		BEHET	ANULLOHET						
44	TIRANA JUG	ISHTE	XHEMAL	MEXHIT	LIKA	652	3976	7/695	349
		BEHET	ANULLOHET						
45	TIRANA JUG	ISHTE	ILMI	BESIM	DUKA	272	8170	7/420	356
		BEHET	ANULLOHET						
46	TIRANA JUG	ISHTE	HASAN	SHAQIR	KURTI	107	3976	7/678	500
		BEHET	ANULLOHET						
47	TIRANA JUG	ISHTE	ALFRED	QANI	LIKAJ	502	3976	7/713	336
		BEHET	ANULLOHET						
48	TIRANA VERI	ISHTE	ALI	MUSTAFA	HOXHA	2089	8320	7/407/2	359
			MUSTAFA	ALI	HOXHA				
		BEHET	MUSTAFA	ALI	HOXHA	2089	8320	7/407/2	359
LIDHJA V									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORÇUMI	EMER	ATEI	MËSHER	NR PROTOKOLLIT VETËDËSHËR PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIS	SIPERFALIA E PARCELES KONTINGJENT PËR KLASIFIKIMIN (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
49	KUKES	Ishte	JAH	SALI	KOVAÇI	9/06	2315	23/197	68.12
			AGRON	HYSEN	BILALI	9/06			
			ELEZ	ISUF	MYZYRI	10/06			
		Behet	LEME	SHERIF	SHAHU	9/06	2315	23/197	68.27
			GJELBRIM	MILAZIM	SHAHU	9/06			
			ELEZ	ISUF	MYZYRI	10/06			



LIDHJA ZH									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDENLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIBE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
50	TIRANA VERI	IShte	FEJZO	HEKURAN	RAPANJ	1372	8310	10/370	119
		BEHET	FEJZO	HEKURAN	RAPANJ	425, 1372	8310	10/370	119
			FREDI	FEJZO	RAPANJ				
LIDHJA AA									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDENLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIBE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
51	LUSHNJE	IShte	NAMIK	KARAMAN	SALIAJ	344	8572	9/260	20.8
			THOMA	LAZO	MECO	345			
			MENTOR	MYNYR	SHEHU	346			
			ARIAN	HALIT	GOGA	347			
			VLADIMIR	HYSEN	MAHMUTAJ	348			
		BEHET	NAMIK	KARAMAN	SALIAJ	344	8572	9/260	29
			THOMA	LAZO	MECO	345			
			MENTOR	MYNYR	SHEHU	346			
			ARIAN	HALIT	GOGA	347			
			VLADIMIR	HYSEN	MAHMUTAJ	348			
52	KUKES	IShte	KUJTIM	ISMAIL	DIDA	101	2282	129/15	300
		Behet	ANULOHET						
LIDHJA AH									
NR RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDENLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURIBE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
53	GJIROKASTER	ishte	BAFTJAR	ZEQO	SULOZEQI	1	1990	1065	100
		behet	BAFTJAR	ZEQO	SULOZEQI	1	1990	834/10	100

**VENDIM****Nr. 808, datë 29.12.2017**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT
TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 20.4.2017,
PËR ÇËSHTJEN “ANA VEIZI DHE TË
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”
(PËR KËRKESËN NR. 16191/13)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 20.4.2017, për çështjen “Ana Veizi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 16191/13), në shumat:

- 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro, për kërkesen Ana Veizi;
- 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro, për kërkesin Klajdi Veizi;
- 15 600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, për kërkesin Zabit Deda;
- 15 600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, për kërkesin Çaushe Veizi,

me qëllim mbulimin e çdo pretendimi në lidhje me çështjen përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe çdo pretendimi tjetër në lidhje me këtë ngjarje, si shpërblime të drejta për dëmin material e moral, së bashku me shumën prej 4 000 (katër mijë) eurosh, për të mbuluar të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke i përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 20.4.2017, për çështjen “Ana Veizi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkesve znj. Ana Veizi, z. Klajdi Veizi, z. Zabit Deda dhe z. Çaushe Veizi, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, brenda 3 (tre) muajve, nga data që vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 817, datë 29.12.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 607, DATË 27.10.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN E MJEDISEVE TË NDËRTESËS
“GODINA E INOVACIONIT” NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
(AKSHI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Emërtimi “Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)” zëvendësohet me “Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)”.

- Pas paragrafit të parë të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) t’i jepen në përdorim mjediset në katin e dytë të godinës së inovacionit, sipas planimetrisë të dhënë në shtojcën 1/3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.”.

b) Pika 4 shfuqizohet.


c) Në pikën 5, pas fjalëve “... Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)...” të shtohen fjalët “... dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)...”.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 12, datë 16.1.2013, “Për kalimin në përdorim të Agjencisë së Prokurimit Publik të disa mjediseve në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik dhe kalimin në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s” dhe nr. 237, datë 7.4.2010, “Për dhënien në përdorim Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve, në administrim të Agjencisë së Prokurimit Publik”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**KËRKESE**

Shtetasja Rudina Raboçi (Korro), kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Korro, i biri i Avniut dhe i Afrovitit, i datëlindjes 6.7.1970, lindur në Përmet dhe banues në Vrine, Bashkia Konispol.

KËRKUESE**Rudina Raboçi (Korro)**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë